

# Armët dhe demensi

FLETUSHKA FAKTIKE NGA QENDRA SUEDEZE PËR DEMENS

Vapen och demens • faktablad på albanska

## Simtomat vështirsojnë marrjen e vendimeve të përshtatshme

Demens është diagnozë, nga një rradhë simptomash, që vështirësojnë të menduarit, planifikimin dhe komunikimin. Këto simptoma janë pasojë e sëmundjeve dhe dëmtimeve të ndryshme të trurit. Në fillim zakonisht përkeqësohet kujtesa dhe orientimi. Në shënjestër janë gjithashtu të folurit dhe aftësitë e tjera mendore.

Simtomat e demensit veçanërisht zmadhohen në raste kur truri duhet të përpunojë një numër të madh informatash dhe të merren vendime të shpejta.

## Rreziku i armëmbajtjes dhe sëmundja e demensit

Aftësitë teknike të përdorimit të armës, humbasin automatikisht me paraqitjen e sëmundjes së demensit.

Sëmundja shkakton ndryshime në tru, të cilat qysh në fillim mund të ndikojnë në aftësitë e përdorimit të armës, përqëndrimin dhe në vlerësimin e situatës.

Me armët në dorë, personat me demens, rrezikojnë ta lëndojnë vetëveten dhe persona të tjerë. Sëmundja e demensit, e bën të vështirë përcjelljen e rregullave, që përcaktojnë deponimin dhe ruajtjen e armës. Për këtë arsye armët mund të bien në duar të gabuara.

## Kërkoni këshillën e mjekut

Drejtohuni mjekut pa hezitim në qoftë se dyshoni në sëmundjen e demensit.


Është me rëndësi që me kohë të fillojnë kontrolimet mjeksore për përcaktimin e diagnozës, marrjes së ndihmës dhe trajtimit të përshtatshëm mjeksor. Në qoftë se përcaktohet diagnoza demens, është me rëndësi që mjeku të informohet se personi ka leje për armëmbajtje.

## Në rast se ekzistojnë pengesa mjeksore

Demensi është një sëmundje që mund të sjellë pengesa për mbajtjen e e mëtejshme të armës. Simbas ligjit për armëmbajtje, është detyrë e mjekut të vlerësojë në qoftë se një pacient është i aftë, nga ana mjeksore,

të posedojë armë zjarri. Në raste të tilla mjeku është i detyruar ta informojë pacientin. Gjithashtu është detyrë e mjekut të paraqesë kërkesë tek organet policore, të cilat më vonë vendosin për mundësinë e mëtejshme të armëmbajtjes.

Zyrtari i organeve policore mundet, gjithashtu, të japë këshilla dhe ndihmë reth çështjes, e cila shfaqet në rast se dikujt i merret leja për armëmbajtje.



## Kjo qështje është shumë e ndjeshme

Tërheqja e lejes për armëmbajtje, mund të jetë shumë e ndjeshme për identitetin dhe vetëbesimin e personit. Për shumë persona gjahu vjeshtor është ngjarja më e rëndësishme e vitit, që paraqet kënaqësi, traditë dhe shoqërim me të tjerët. Për këtë arsye është mirë që familjarët apo të afërmit e tjerë sa më herët të angazhohen në disuktim rreth lejes për armëmbajtje. Ndoshta ekziston mundësia që personi i sëmurë mundet të marrë ndonjë rol tjetër në grupin e gjahut.

## Informatat e mëtejshme

*Regjistrimi i pacientëve, të cilët për shkaqe mjeksore, janë të paperështatshëm të mbajnë armë zjarri.*

*Udhëzimi administrativ Social-shëndetsor*

• [www.socialstyrelsen.se](http://www.socialstyrelsen.se)

*Ligji mbi armët, Rregullorja për ligje në Suedi (1996:97)* • [www.notisum.se](http://www.notisum.se)

30 janar 2016 • Svenskt Demenscentrum®

Më shumë informata në gjuhët e ndryshme mund ti lexoni në portalin Qendra Suedeze për demens: [www.demenscentrum.se/Faktablad](http://www.demenscentrum.se/Faktablad)



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Gävlegatan 16, 113 30 Stockholm, 08 - 690 58 00, [info@demenscentrum.se](mailto:info@demenscentrum.se)

[www.demenscentrum.se](http://www.demenscentrum.se)